

BARAZIA NË FINLANDË

Informacione
për imigrante
dhe imigrantë



SISÄASIAINMINISTERIÖ
MINISTRIA E BRENDSHMË



VÄHEMMISTÖVALTUUTETTU

OMBUDSMANI PËR
MINORITETE



TASA-ARVOVALTUUTETUN TOIMISTO

ZYRA E OMBUDSMANIT PËR
BARAZINË



Në këtë broshurë flitet për

Shoqërinë finlandeze _____	3
Pozitën e barabartë të grave dhe burrave në familje _____	5
Mirëqenien e fëmijës _____	9
Ndihmën që mund të merret për problemet familjare dhe për problemet e të rinjve _____	11
Shkollimin dhe punën _____	16
Trafikimin e qenieve njerëzore _____	20
Informacione mbi autoritete zyrtare të rëndësishme _____	21

Përditësimi i materialit (Käsikirjoituksen päivitys): Juhani Sippola
Grupi i punës (Työryhmä): Leena-Maija Qvist, Ministria e Brendshme,
Pirjo Kruskopf, Zyra e ombudsmanit për minoritete dhe
Minna Lundell-Kiuru, Zyra e ombudsmanit për barazi
Faqosja dhe shtypja: Edita Prima Oy, Helsinki 2010

Broshura është përkthyer në gjuhët e mëposhtme: shqip, arabisht, darisht, anglisht,
në gjuhën kurde (në gjuhën sorane), në persisht, somalisht, finlandisht, në gjuhën tagalog,
në gjuhën tailandeze, në rusisht dhe në vietnamisht

Informacione mbi shoqërinë finlandeze

Në këtë broshurë flitet për gratë, burrat si dhe për familjet e tyre që shpërngulen në Finlandë dhe përmban informacione për jetën familjare, për edukimin e fëmijëve, për shkollimin dhe për punën.

E drejta për trajtim të barabartë

Në bazë të ligjeve, të gjithë njerëzit në Finlandë kanë të drejtën për trajtim të barabartë. Në ligjet e barazisë ndalohet diskriminimi në bazë të moshës, të origjinës etnike dhe të shtetësisë, të gjuhës, të besimit fetar, të besimeve, të mendimeve, të gjendjes shëndetësore, të paaftësisë (invaliditetit) dhe të orientimit seksual. Ligji i barazisë ka zbatim të gjerë për shembull, në marrjen në punë, në shkollim dhe në shërbimet sociale e shëndetësore. Në bazë të ligjit të barazisë ndalohet diskriminimi gjinor. Gjithashtu është e ndaluar edhe diskriminimi për shkak të shtatzënisë, lindjes, të të qenurit prind ose në bazë të detyrimit për kujdesin ndaj familjes. Qëllimi i ligjit të barazisë është përkrahja e barazisë midis burrave dhe grave në punë, në pagesën e rrogës, në shkollim, në harmonizimin e jetës së punës me jetën familjare dhe në të gjithë shoqërinë.

Shërbimet publike

Në shërbimet publike bëjnë pjesë shërbimet themelore të qytetarëve, ndër të cilët më të rëndësishmit kanë të bëjnë me kujdesin social dhe shëndetësor, me shkollimin dhe arsimin, me ambientin, mirëmbajtjen e rrjetit të rrugëve, të ujit dhe të kanalizimeve. Organizimi i shërbimeve të lartpërmendura është përgjegjësi e komunave. Në përgjegjësinë e shtetit bëjnë pjesë për shembull, shërbime të tilla publike si, policia, zy-

rat e punësimit dhe sipërmarrjes si dhe autoritetet zyrtare të mbrojtjes në punë. Në Finlandë ka një sistem drejtësie, i cili është neutral dhe i pavarur nga vendimmarrësit politikë. Organizatat plotësojnë shërbimet publike.

Të drejtat themelore të qytetarëve

Të drejtat themelore të qytetarëve përfshijnë, ndër të tjera, të drejtën për të votuar, lirinë e besimit fetar, lirinë e mendimit, grumbullimit dhe lirinë e fjalës, të drejtën për ruajtjen e sekretit të letrave, të drejtat e fëmijëve si dhe të drejtën për shkollim të barabartë. Në Finlandë, vendbanimi mund të zgjidhet sipas dëshirës dhe personi mund të lëvizë lirisht. Detyra e shtetit dhe e komunave të banimit është që, në rast nevojë, të garantojnë një jetë të denjë për njeriun.

► TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE DËNOHET RREPTËSISHT ME LIGJ

Në trafikimin e qenieve njerëzore, viktima shfrytëzohet në mënyrë seksuale dhe/ose ekonomike. Informacione të mëtejshme mbi këtë temë në faqen 20.

► PËRKTHIMI

Nëse nuk keni njohuri të mjaftueshme gjuhësore për të komunikuar me autoritetet zyrtare, atëherë i pyesni ato për mundësinë e përdorimit të përkthyesit. Fëmija nuk duhet të përdoret si përkthyes.

Barazia midis gruas dhe burrit në jetën familjare

Bashkëshortët kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime. Në Finlandë shoqërimi dhe lidhja e martesës bazohen në vullnetin e lirë. Gratë dhe burrat mund ta zgjedhin me dëshirën e tyre partnerin. Prindët nuk vendosin për martesën e fëmijëve dhe as për bashkëshortët e tyre.

Familje të ndryshme

Koncepti i familjes tipike finlandeze është babai, nëna dhe fëmijët e familjes. Për këtë shkak familjet janë zakonisht, të vogla.

Familja mund të përbëhet edhe nga burri dhe gruaja, të cilët banojnë bashkë, por nuk janë të martuar. Në këtë rast, burri dhe gruaja konsiderohen se bashkëjetojnë. Edhe partnerët, të cilët i përkasin të njëjtës gjini, mund të bashkëjetojnë ose të jetojnë në një marrëdhënie të regjistruar. Me partnerë nënkuptohen çiftet, të cilët janë të martuar, që jetojnë në një marrëdhënie të regjistruar ose që bashkëjetojnë.

Lidhja e martesës në Finlandë

Në Finlandë martesë lidhet nëpërmjet ceremonisë në kishë ose nëpërmjet martesës në gjendjen civile, për shembull, në zyrën e gjendjes civile. Para martesës shqyrtohen kushtet, nëse ka ndonjë pengesë për t'u martuar apo jo.

Shqyrtimi mund të bëhet nga zyra e gjendjes civile ose nga famullia, anëtarët e të cilës janë bashkëshortët e ardhshëm, ose në rast se njëri prej bashkëshortëve është anëtar. Sipas ligjeve të Finlandës, personi nuk mund të martohet nëse ai/ajo është ende i martuar.

Edhe moshë nën 18-vjeç dhe lidhja e afërt farefisnore konsiderohen si pengesa për martesën. Pengesat për martesë shqyrtohen sipas ligjit finlandez, të paktën nëse njëri prej bashkëshortëve është nënshtrëtas i Finlandës ose nëse banon në Finlandë.

Para lidhjes së martesës, bashkëshortët vendosin për mbiemrin e përbashkët. Sipas ligjit të Finlandës, ata mund të mbajnë ose mbi-

emrat e tyre përkatës, ose të marrin mbiemrin e njërit prej bashkëshortëve. Gjithashtu, ata mund të vendosin që për mbiemër të mbajnë një kombinim të mbiemrave të secilit prej tyre, ku vendoset si mbiemri i njërit, ashtu dhe mbiemri i bashkëshortit tjetër.

Bashkëshorti konsiderohet babai i fëmijës që lind në martesë, pa patur nevojë për masë të veçanta. Atësia e fëmijëve që lindin jashtë martesës duhet verifikuar te mbikqyrësi i interesave të fëmijës, pranë komunës së banimit. Nëpërmjet verifikimit të atësisë së fëmijës, garantohej të drejtat e fëmijës, për shembull, në ndarjen e trashëgimisë.

Të njëjtat të drejta dhe detyrime

Sipas ligjit të Finlandës, të dy bashkëshortët gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyrime. Të dy bashkëshortët mund të marrin pjesë në ekonominë e familjes duke punuar. Nëse njëri prej bashkëshortëve nuk punon, atëherë ai/ajo jep kontributin përkatës duke bërë punë në shtëpi. Bashkëshorti që punon ose ai/ajo që fiton më shumë të ardhura, duhet t'i japë bashkëshortit tjetër të holla për blerjet për shtëpinë e përbashkët dhe për nevojat bazë personale. Nëse bashkëshorti që fiton më shumë nuk e pranon një gjë të tillë, atëherë në rast nevojë, ai/ajo mund të detyrohet t'i paguajë bashkëshortit tjetër alimentacion.

Bashkëshortët vendosin për pasurinë e tyre

Bashkëshortët e vendosin vetë për pasurinë e tyre. Sipas ligjit, të dy bashkëshortët janë pronarë të asaj pasurie, të cilët ata kishin para

martësës ose atë të cilën e fitojnë gjatë martësës. Megjithatë, asnjë prej bashkëshortëve nuk mund ta shesë ose ta dorëzojë pasurinë pa miratimin e bashkëshortit tjetër, për shembull, banesën që shërben si shtëpi, mobiljet dhe as orënditë e fëmijëve.

Nëse bashkëshorti merr i vetëm borxh, atëherë vetëm ai/ajo është përgjegjës për shlyerjen e borxhit. Në rastin e borxhit të marrë bashkarisht si dhe në rastin e borxhit që ka marrë njëri nga bashkëshortët për jetesën e familjes, përgjigjen të dy bashkëshortët.

Ligji mbi pasurinë

Zakonisht për marrëdhëniet e pasurisë së bashkëshortëve zbatohet ligji i atij shteti, i cili është edhe vendbanimi i bashkëshortëve në momentin e lidhjes së martësës. Nëse bashkëshortët më vonë ndërrojnë vendbanimin në një tjetër shtet, atëherë zbatohet ligji i atij shteti.

Megjithatë, ligji i vendbanimit të ri zbatohet zakonisht, vetëm pasi bashkëshortët të kenë banuar në atë shtet për të paktën pesë vjet.

Nëse kur lidhin martesë, bashkëshortët vendosin të banojnë përgjithmonë në Finlandë, atëherë pasojat mbi pasurinë do të përcaktohen sipas ligjit të Finlandës. Nëse bashkëshortët kanë jetuar fillimisht në një shtet tjetër dhe më vonë shpërngulen në Finlandë, ligji i Finlandës zbatohet në rastin e tyre vetëm pasi ata të kenë banuar pesë vjet në Finlandë. Para përmbushjes së kësaj kohe, zbatohet ligji i shtetit ku kanë banuar. Megjithatë, në rastin e personave që kthehen në atdhe, ligji i Finlandës zbatohet menjëherë, që prej kohës kur bashkëshortët janë vendosur me banim të përhershëm këtu.

Kontrata mbi ndarjen e pasurisë

Bashkëshortët mund të vendosin nëpërmjet kontratës me shkrim, që për pasurinë e martësës të zbatohet për shembull, ligji i shtetit të mëparshëm ose ligji i shtetit, të vendbanimit të mëparshëm. Bashkëshortët që shpër-

ngulen në Finlandë, mund edhe të bien dakort për shembull, që ligji i Finlandës të zbatohet për pasurinë. Para se bashkëshortët të kenë banuar këtu që prej pesë vjetësh. Për hartimin e kontratës, shpesh është mirë që të kërkohet ndihmë nga zyra e ndihmës legale ose nga ndonjë avokat.

E drejta e trashëgimisë

Në Finlandë, gratë dhe burrat kanë të njëjtat drejta për trashëgiminë. Fëmijët dhe pasardhësit e tyre kanë të drejtë për të trashëguar pasurinë e prindërve, pas vdekjes së prindërve. Nëse njeri nga bashkëshortët vdes, por nuk kane trashëguar asnjë fëmijë, atëherë bashkëshorti që ende është gjallë, trashëgon të gjithë pasurinë e bashkëshortit që vdes.

Megjithatë, ky rregull nuk zbatohet, nëse bashkëshorti e ka ndarë ndryshe trashëgiminë me anë të një testamenti. Hartimi i dokumentit të trashëgimisë, pra i testamentit, siguron që njerëzit të influencojnë në mënyrën e ndarjes së pasurisë, pas vdekjes.

Zakonisht, imigranti ka të njëjtat drejta mbi trashëgiminë, si edhe shtetasi i Finlandës. Në trashëgimi zbatohet, në fillim, ligji i shtetit ku ka banuar personi i ndjerë. Edhe ligji që zbatohet për trashëgiminë mund të përcaktohet në testament.

Ndihmë për çështjet e trashëgimisë dhe për hartimin e testamentit ofrojnë për shembull, zyrat e shtetit, të ndihmës legale si dhe avokatë të ndryshëm.

Dallimi midis martësës dhe bashkëjetesës

Me bashkëjetesë nënkuptohet marrëdhënia kur bashkëshortët jetojnë bashkë, por ata nuk janë të martuar me njëri-tjetrin. Bashkëjetesa njihsohet me martesën në shumë raste, për shembull, në vendimet mbi sigurimin social. Në bashkëjetesë është e rëndësishme të bihet dakort se si do të ndahet pasuria e përbashket pas ndarjes ose pas vdekjes së njërit prej bashkëshortëve. Kontratat mbi pasurinë duhet të hartohen me shkrim.

Sipas ligjit të Finlandës, bashkëjetesa dallohet nga martesja, si për shembull, në mënyrat e mëposhtme:

- > Fëmijët e bashkëshortëve që jetojnë në bashkëjetesë, nuk kanë të njëjtat të drejta si fëmijët e bashkëshortëve të martuar, megjithatë të drejtat e tyre sigurohen nëpërmjet verifikimit të atësisë së fëmijës.
- > Nëse bashkëshortët që jetojnë në bashkëjetesë ndahen, atëhere secili prej tyre mban pasurinë vetjake, nëse nuk ka kontratë të veçantë mbi këtë çështje.
- > Nëse nuk ka testament, bashkëshortët që jetojnë në bashkëjetesë, nuk trashëgojnë asgjë nga pasuria e njëri-tjetrit.

Bashkëjetesa mund të përbëjë arsye për marrjen e lejeqëndrimit dhe autoritetet zyrtare vendosin mbi miratimin e lejeqëndrimit sipas rasis në fjalë.

Planifikimi familjar dhe këshilla për parandalimin e shtatzënisë

Qendrat shëndetësore japin këshilla mbi planifikimin familjar dhe parandalimin e shtatzënisë. Mjete parandaluese për burra mund të blihen në ushqimore dhe në farmaci. Për mënyrat e parandalimit të shtatzënisë për gra, mund të bisedoni dhe mund të merrni infor-

macione për to në qendrat shëndetësore, gjatë takimit me mjekun.

Gruaja mund të sigurohet për shtatzëninë e saj, ose duke bërë testin e shtatzënisë në qendrën shëndetësore, ose mund të blejë testin e shtatzënisë në farmaci dhe pastaj ta bëjë vetë atë.

Është e rekomandueshme që gratë të shkojnë rregullisht për t'u kontrolluar te mjeku gjinekolog. Zakonisht, gratë dëshirojnë që të vizitohen te mjekja gjinekologe.

Ndërprerja e shtatzënisë

Ndërprerja e shtatzënisë menjëherë pas marrëdhënies seksuale, me anë të ilaçit, quhet abort terapeutik (abort me ilaç). Arsye të zakonshme për abortin terapeutik janë mosfunksionimi i parandalimit të shtatzënisë ose përdhunimi. Vajzat mbi moshën 15-vjeç mund të marrin tableta për abort terapeutik në farmaci, pa patur nevojë për recetë. Në Finlandë, ndërprerja e shtatzënisë, pra aborti, bëhet vetëm po të plotësohen disa kriteret e caktuara. Ndërprerja e shtatzënisë mund të bëhet vetëm kur lindja përbën rrezik për shëndetin e nënës ose kur shtatzënia dhe lindja përbëjnë një stërmundim të jashtëzakonshëm për jetën e nënës.

Zgjedhja e mbiemrit influencon edhe në mbiemrin që do të marrë fëmija meen

ALTERNATIVA 1

Bashkëshortët marrin në përdorim ose mbiemrin e burrit ose të gruas. Bashkëshorti i/e cili ndërron mbiemrin, mund të përdorë një mbiemër që përbëhet nga mbiemri i vjetër, i pasuar nga mbiemri i ri.

Në këtë rast, fëmijët marrin mbiemrin e prindërve.

ALTERNATIVA 2

Secili nga bashkëshortët ruan mbiemrin e vet.

Në këtë rast, prindët mund të zgjedhin nëse fëmijët do të marrin mbiemrin e babait apo të nënës. Të gjithë fëmijët duhet të kenë të njëjtin mbiemër.

Gruaja bën abort në rast se e dëshiron, kur ajo është nën 17-vjeç ose mbi 40-vjeç. Ndërprerja e shtatzënisë për arsye sociale, duhet bërë gjatë 12 javëve të para, të shtatzënisë.

Në Finlandë, për bërjen e abortit duhet të merret gjithmonë pëlqimi i nënës. Nëse nëna mendon bërjen e abortit, atëherë ajo duhet të kontaktohet sa më shpejt me mjekun.

Ndihmë gjatë shtatzënisë

Është e rëndësishme që nëna shtatzënë të shkojë për kontrollë në qendrën shëndetësore. Në këshillimoret për nëna dhe fëmijë ofrohen shërbime falas shëndetësore dhe kurse përgatitore për lindje, që kanë si qëllim mirëqenien e nënës dhe të foshnjës.

Nëna shtatzënë duhet të shkojë për vizitë në këshillimoren për nëna dhe fëmijë ose për vizitë te mjeku, para përfundimit të muajit të katërt të shtatzënisë. Vetëm nënat të cilat kanë qenë në kontrollet mjekësore, kanë të drejtë për të marrë mbështetjen financiare për nëna.

Nëpërmjet vizitave të rregullta në këshillimoren për nëna dhe fëmijë, ndiqet mirëqenia e nënës dhe fëmijës gjatë kohës së shtatzënisë. Vizitat në këshillimore janë falas.

Edhe baballarët mund të vijnë në vizitat e nënës në këshillimoret për nëna dhe fëmijë, ku jepen kurse përgatitore për lindjen e fëmijës.

Në Finlandë lindjet bëhen në spital. Edhe babai i fëmijës mund të jetë i pranishëm gjatë lindjes. Madje shumë baballarë dëshirojnë të jenë të pranishëm gjatë lindjes, për t'i dhënë mbështetje nënës.

Strehimorja

Shtatzënia e papritur dhe lindja e fëmijës mund të përbëjnë probleme, veçanërisht në rastin kur nëna është në moshë shumë të re ose kur nëna dhe babai i fëmijës nuk janë të

martuar, ose kur njëra nga palët nuk dëshiron të martohet. Në raste të tilla, gruaja shtatzënë ose nëna dhe fëmija mund të shkojnë në strehimore. Në rast nevojë, edhe babai mund të banojë në strehimore.

Zakonisht nëna dhe fëmija jetojnë në strehimore për gjashtë muaj. Në strehimore jepen këshilla mbi rolin e nënës dhe mbi çështjet që kanë të bëjnë me kujdesin për fëmijën. Në strehimore jepen këshilla edhe mbi rolin e prindit. Informacione mbi strehimoret mund të merrni në zyrën e socialit, të komunës dhe në këshillimoren për nëna dhe fëmijë.

Pushimi për nënën dhe për babanë, pas lindjes së fëmijës

Pas lindjes, prindët e fëmijës kanë të drejtë ligjore për pushime familjare. Ndër pushimet më të rëndësishme për nënën dhe babanë janë pushimi për nënën dhe pushimi për babanë. Pas pushimit për nënën, nëna dhe babai ose të dy prindët njëri pas tjetrit, mund të marrin pushimin për prindër.

Sipas ligjit, nëna ka të drejtë ligjore për pushimin për nënën, që zgjat 105 ditë jave. Për pushimin për nënën, sikundër edhe për pushimin për babanë dhe pushimin për prindër, paguhen kompensime në të holla gjatë gjithë periudhës së pushimit në fjalë.

Nga pushimi për nënën, një pjesë prindoret para kohës së llogaritur të lindjes dhe pjesa tjetër pas lindjes. E drejta për pushim për nënën ka si kriter që, nëna të ketë banuar në Finlandë të paktën 180 ditë para kohës së llogaritur të lindjes dhe që shtatzënia e nënës të ketë zgjatur të paktën 154 ditë.

Informacione të mëtejshme mbi pushimet për nënën, për babanë dhe për prindët, kanë këshillimoret për nëna dhe fëmijë dhe zyrat e Kela-s, në komunën tuaj të banimit.

Mirëqenia e fëmijës



Finlanda është angazhuar për zbatimin e marrëveshjes së OKB-së, për të drejtat e fëmijëve. Në bazë të marrëveshjes, fëmija ka të drejtë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë, për të patur pjesën që i takon në burimet e shoqërisë, si dhe për të marrë pjesë sipas moshës dhe nivelit të zhvillimit, në vendimet që kanë të bëjnë me të.

Në Finlandë vajzat dhe djemtë gëzojnë të njëjtat të drejta. Në Finlandë, goditja e fëmijës ose format e ndryshme të disiplinimit në mënyrë fizike, janë të ndaluara me ligj.

Shoqëria merr pjesë në kujdesin shëndetësor të fëmijës, së bashku me prindët. Që kur fëmija lind, deri sa ai të mbushë shtatë vjeç, mirëqenia e tij ndiqet nga afër nëpërmjet kontrolleve në këshillimoren për nëna dhe fëmijë.

Atje, shëndeti i fëmijës kontrollohet në afate të rregullta kohore. Në këshillimoren për nëna dhe fëmijë bëhen edhe vaksinimet e duhura. Si dhe jepen informacione mbi kujdesin për rritjen e fëmijës dhe mbi rolin e prindit.

Për mirëqenien e fëmijëve të moshave shkollore, përgjigjen motra medicinale e shkollës, mjeku dhe dentisti i shkollës, në bashkëpunim me prindët e fëmijës.

Ndihmë financiare për familjet me fëmijë

Jetesa e familjeve me fëmijë ndihmohet nëpërmjet përfitimeve të ndryshme financiare. Një pjesë e këtyre ndihmave u takon të gjithë banorëve të Finlandës. Ndërsa për disa përfitime të tjera financiare, kriter është banimi për një kohë të caktuar në Finlandë.

Informacione të mëtejshme mbi përfitimet që u takojnë familjeve me fëmijë, mund të merrni në zyrën e Institucionit të Sigurimit Social, pra nga zyrat e Kela-s, ku mund të aplikoni edhe për ndihmën financiare. Edhe në këshillimoren për nëna dhe fëmijë të qendrës shëndetësore, mund të merrni informacione se kur mund të aplikoni për ndihmën financiare.

Kujdesi për fëmijët

Fëmijët e moshës parashkollore, në rast nevojë mund të shkojnë gjatë ditës në çerdhe ose në çerdhe familjare. Në çerdhe ka një personel të shkolluar. Edhe edukatorët e çerdheve familjare janë shkolluar në profesionin e tyre.

Kujdesi ditor komunal ose privat ndihmon në zhvillimin e balancuar dhe të shumëllojshëm të fëmijës. Në sajë të kujdesit ditor, si nëna ashtu dhe babai mund të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në shkollim ose mund të punojnë jashtë shtëpisë.

Pagesa për kujdesin ditor përcaktohet në bazë të të ardhurave të familjes. Për familjet me të ardhura të ulëta, kujdesi ditor është falas. Informacione të mëtejshme mbi kujdesin ditor për fëmijët, mund të gjeni në zyrën e informacionit të kujdesit ditor komunal. Mbi mënyrat e studimit të kujdesit për fëmijë, mund të informoheni në zyrat e Institutit të Sigurimit Social, pra në zyrat e Kela-s.

Nëna dhe babai mund të marrin leje nga puna pa të drejtë rroge, për t'u kujdesur për fëmijën në shtëpi. Prindi që rri në shtëpi ndihmohet financiarisht nëpërmjet mbështetjes për kujdesin ndaj fëmijës në shtëpi, deri sa fëmija të mbushë moshën tre vjeç.

Arsimi i detyruar prek vajzat dhe djemtë

Në Finlandë vajzat dhe djemtë kanë mundësi të barabarta për të shkuar në shkollë dhe për të mësuar.

Të gjithë fëmijët me banim të përhershëm në Finlandë, duhet të ndjekin arsimin e dety-



ruar për të gjithë. Kjo nënkupton se, edhe fëmijët e imigrantëve duhet të ndjekin shkollën fillore 9-vjeçare.

Para fillimit të shkollës, fëmijët mund të marrin pjesë në mësimin parashkollor që organizohet nga çerdhja ose nga shkolla. Shkolla fillore zakonisht fillon në vitin kur fëmija mbush moshën 7 vjeç.

Shkollimi fillor si dhe materialet mësimore, ushqimi në shkollë dhe kujdesi shëndetësor janë falas. Informacione të mëtejshme për çështjet që kanë të bëjnë me shkollimin, mund të merrni në zyrën për shkollim ose për arsim të komunës ku banoni si dhe nga personeli i shkollave.

Pas shkollimit fillor nëntëvjeçar, alternativa më e zakonshme është ose studimi në gjimnaz që ofron arsim të përgjithshëm ose në institucionet shkollore profesionale. Pas kësaj, studimet mund të vazhdojnë në shkollimin e lartë, në shkollat e larta profesionale ose në universitet.

Një gjuhë e mësuar mirë, është e rëndësishme për fëmijën

Monikulturalizmi është një burim i çmuar energjie për fëmijën. Prindët mund ta përkrahin këtë burim duke i folur fëmijës në gjuhën amtare dhe duke e njohur atë me kulturën e vet. Gjuhën dhe kulturën finlandeze fëmijët i mësojnë jashtë shtëpisë, në çerdhe dhe në shkollë.

► Ndhimë financiare për familjet me fëmijë

- të gjitha nënat me banim në Finlandë, të cilat kanë kryer kontrollet e rregullta shëndetësore në këshillimore ose te mjeku, para përfundimit të periudhës katërmujore të shtatzënisë, kanë të drejtë të marrin ndihmën për nëna shtatzënë. Paketa e ndihmës përmban veshje dhe lodra për fëmijën e porsalindur.
- paratë ditore për prindin i paguhen prindit që kujdeset për foshnjën në shtëpi, gjatë dhjetë muajve të parë të jetës së foshjes. Paratë ditore përbëhen nga ndihma financiare për nënën shtatzënë, ndihma financiare për babanë dhe ndihma financiare për prindin. Shuma e tyre përcaktohet në bazë të të ardhurave. Prindët, të cilët nuk kanë qenë në punë, marrin minimumin e parave ditore.
- shpenzimet e familjes me fëmijë lehtësohen edhe nëpërmjet shtesave të fëmijëve, të cilat paguhen çdo muaj, për çdo fëmijë të moshës nën 17-vjeç, me banim të përhershëm në Finlandë.

► Kur mund ta marrë fëmija nënshtetësinë e Finlandës

Kur lind fëmija, ai/ajo e merr nënshtetësinë e Finlandës në qoftë se

- në kohën e lindjes, nëna e fëmijës është nënshtetase e Finlandës
- babai i fëmijës është nënshtetas i Finlandës dhe është i martuar me nënën e fëmijës, e cila ka nënshtetësi të huaj
- babai i fëmijës ka vdekur, por në kohën e vdekjes ai ka qenë nënshtetas i Finlandës dhe i martuar me nënën e fëmijës
- fëmija lind në Finlandë dhe në kohën e lindjes nuk mund të marrë asnjë nënshtetësi tjetër

► Ndalohet rrethprerja e vajzave

Në Finlandë, në bazë të ligjit, prerja e organeve gjinitale të vajzave dhe grave për arsye fetare ose për arsye të tjera, përbën shkelje ligjore. Për përdorimin e kësaj praktike, personi mund të dënohet me disa vite burgim.

► Rrethprerja e djemve

Në Finlandë, rrethprerja e djemve nuk është e ndaluar. Megjithatë, ajo duhet bërë vetëm në kushte ku të kenë njohuri mjekësore, higjienë dhe ilaçe për lehtësimin e dhimbjes.

Ndhimë për problemet në familje dhe problemet e të rinjve



Në Finlandë ofrohen ndihma në mënyra të ndryshme për problemet personale ose ato familjare. Përdorimi i shërbimeve komunale është falas dhe konfidencial.

Njeriu nuk ka gjithmonë fuqi dhe mënyra për t'i zgjidhur konfliktet në çift, problemet me fëmijët, problemet personale ose të të tjerëve. Problemet e pazgjidhura e përkeqësojnë situatën. Për këtë arsye, ia vlen të kontaktoni me shërbimet komunale pa humbur kohë. Ndhimë mund të merrni edhe nga organizatat për imigrantë dhe nga organizata të tjera që funksionojnë në komunën e banimit.

Konflikte në marrëdhëniet me njerëzit dhe në jetën familjare

Këshillimoret për familje ndihmojnë në problemet lidhur me marrëdhëniet njerëzore, me problemet familjare dhe me problemet me edukimin e fëmijës. Mundësia për zgjidhje të problemeve familjare që ofrohet nga komuna, është falas dhe absolutisht konfidenciale.

Përshtatja me vendin dhe kulturën e re mund të jetë një përvojë e vështirë shpirtërore. Edhe vështirësitë e përjetuara në atdhe dhe fati i personave që kanë mbetur atje, si i prindërve, i motrave dhe vëllezërve dhe i të afërmeve të tjerë të familjes, mund të shkaktojnë shqetësim dhe mërzë. Në raste të tilla, ja vlen të kontaktoni menjëherë shërbimet për shëndetin mendor, në komunën e banimit. Këto shërbime ofrojnë kujdes dhe këshilla lidhur me problemet e shëndetit mendor.

Qendra për kriza "SOS" iu shërben imigrantëve që banojnë në Finlandë dhe familjeve të tyre. Qendra që gjendet në Helsinki ofron ndihmë për problemet e shëndetit mendor dhe në raste krizash. Edhe Shoqata për Shëndetin Mendor, e Finlandës Jugperëndimore, që gjendet në Turku, ofron ndihmë për imigrantët në raste krizash.

Refugjatët të cilët kanë qenë viktimat e torturave dhe të afërmit e tyre, marrin ndihmë nga Qendra e Rehabilitimit për të Keqtrajtuar. Ajo ndodhet në Helsinki. Në këtë qendër mund të vizitohen ata persona, të cilët kanë marrë rekomandim për rehabilitim nga mjeku i qendrës shëndetësore të komunës ose nga mjeku privat. Edhe në Oulu funksionon një degë e kësaj qendre, që ofron shërbime për rehabilitimin e njerëzve të keqtrajtuar.

Ndërhyrja e shpejtë në problemet e fëmijëve dhe të të rinjve

Fëmijët dhe të rinjtë përshtaten shumë shpejt me kulturën e re. Ata marrin zakonet e rrethit të shoqërisë dhe të shkollës, që për prindët mund të jetë e vështirë për t'i kuptuar.

Përshtatja e kulturës amtare dhe të zakonave të reja që fitojnë fëmijët, mund të shkaktojë konflikte në familje.

Jashtë shtëpisë ose në shkollë, fëmijët dhe të rinjtë mund të përjetojnë edhe ngacmime. Madje edhe mbarëvajtja në shkollë mund të jetë me vështirësi.

Edhe në problemet më të vogla duhet ndërhyrë me kohë. Fillimisht ia vlen të kontaktoni mësuesen e shkollës ose personelin e çerdhes. Nëse nuk ndërhyni me kohë, atëherë problemet mund të ndërlikohen.

Për problemet me fëmijët dhe me të rinjtë, mund të kërkoni ndihmë në këshillimoret për familje dhe në zyrën e shëndetit mendor, të komunës ku banoni.

Kallëzim në polici në rast keqtrajtimi të bashkëshortes (bashkëshortit) ose fëmijëve

Keqtrajtimi i bashkëshortes ose i fëmijëve për-

bën dhunë në familje. Dhuna në familje nuk ndalon vetvetiu, përkundrazi, në shumicën e rasteve ajo përqësohet. Sjellja e dhunshme në familje nuk mund mbrohet, për shembull, nëpërmjet zakoneve kulturore. Në Finlandë, dhuna në familje përbën shkelje ligjore.

Personi që ka qenë viktimë e dhunës, duhet të bëjë kallëzim penal në polici dhe të shkojë për kontroll te mjeku.

Dhuna që ushtrohet ndaj bashkëshortes ose ndaj fëmijëve mund të jetë fizike, mendore, ekonomike ose seksuale. Në Finlandë, dënimi i fëmijës nëpërmjet rrahjes është i ndaluar me ligj.

Në komunat më të mëdha të Finlandës, ka strehimore të cilat ndihmojnë viktimat e dhunës. Të drejtën për strehim në këtë strehimore e kanë edhe banorë të komunave të tjera.

Ndihmë mund të merrni edhe në zyrën e socialit, në qendrën shëndetësore, në zyrën e shëndetit mendor dhe në këshillimorën për fëmijë, që gjenden në komunën ku banoni. Për dhunën në familje mund të flisni edhe në këshillimorën për nëna dhe fëmijë. Është detyra e nëpunësve zyrtarë për t'ju ndihmuar.

Edhe personi keqtrajtuës ka nevojë për ndihmë. Autoritetet zyrtare të komunës ku banoni dhe personat e specializuar në ndihmën për ushtruesit e dhunës, ndihmojnë të gjithë ata, të cilët dëshirojnë t'i japin fund sjelljes së dhunshme.

Strehimoret për viktimat nga dhuna

Çdo person që është viktimë e dhunës në shtëpi, mund të kërkojë të banojë në strehimore. Në rast krize ose urgjence, njeriu mund të shkojë direkt në strehimore. Me strehimoren mund të kontaktoheni edhe nëpërmjet telefonit ose nëpërmjet zyrës sociale.

Në strehimore, prindi dhe fëmijët mund të banojnë përkohësisht, nëse banimi në shtëpi është i pamundur ose i rrezikshëm për shkak të dhunës, të kërcënimit ose të frikës.

Bashkë me punëtorët e strehimores mund të mendoni zgjidhje për problemet dhe mënyra për ndërprerjen e ciklit të dhunës. Vetë klienti i bën zgjidhjet. Strehimoret dhe linjat e tyre tele-

fonike për krizën janë të hapura 24 orë në ditë. Edhe komuna ka banesa në raste krizash ose për raste sigurie.

Përdhunimi ndalohet edhe në martesë

Në bazë të ligjit të Finlandës, përdhunimi përbën një krim. Edhe përdhunimi i bashkëshortes është krim. Viktima e përdhunuar duhet të kontaktojë policinë dhe të vizitohet te mjeku, menjëherë pas ngjarjes.

Përdhunimi nuk është faji i viktimës, ndaj dhe viktimës nuk ka pse t'i vijë turp. Viktima nga përdhunimi mund të kërkojë ndihmë për problemet e shkaktuara nga përdhunimi, pranë autoriteteve zyrtare, të komunës ku banon.

Në Helsinki ndodhet qendra e krizës për personat e përdhunuar "Tukinainen", që i shërben të gjithë vendit.

Arsyet e divorcit nuk ka pse t'u spjegohen zyrtarëve

Martesa është kontratë me dëshirë të lirë. Ajo mund të priset. Divorci mund të merret në konsideratë, nëse jeta me partnerin është e pamundur. Në Finlandë, divorci mund të jepet, edhe nëse pala tjetër nuk e dëshiron atë. Arsyet e divorcit dhe marrëdhëniet midis bashkëshortëve nuk kanë nevojë t'u spjegohen autoriteteve zyrtare. Në vendosjen për pozitën e fëmijëve, burri dhe gruaja kanë të njëjtat të drejta.

Secili prej tyre mund ta fillojë procesin e divorcit. Kjo bëhet duke plotësuar formularin për divorc në gjykatën komunale, në komunën ku banoni. Ndihmësi legal i zyrës së shtetit, për ndihmë legale ju ndihmon në plotësimin e formularit dhe me çështjet juridike që kanë të bëjnë me divorcin.

Gjatë divorcit merret vendim për ndarjen e banesës dhe të pasurisë. Nëse familja ka fëmijë, atëherë gjatë divorcit duhet të vendoset për kujdestarinë e fëmijëve.

Kujdestaria e fëmijëve gjatë divorcit

Detyra e kujdestarit të fëmijës është të përgjigjet për mirëqenien, edukimin dhe për zhvillim-

min e gjithanshëm të fëmijës. Kujdestari nënkupton të drejtën për t'u kujdesur për fëmijën dhe të drejtën për të marrë vendime që kanë të bëjnë me të.

Në rast nevoje, kujdestari e përfaqëson fëmijën në gjyqe dhe para autoriteteve zyrtare. Vetëm kujdestari mund të ketë shënimet e fëmijës në pasaportën personale.

Gjatë divorcit, kujdestar i fëmijës nuk emërohet automatikisht njëri prej prindërve. Nëna dhe babai i fëmijës kanë pozita të barabarta kur vendoset për kujdestarinë e fëmijës. Prindët mund të bëjnë një kontratë për kujdestari të përbashkët.

Në rast se është e mundur, gjatë procesit të divorcit prindët bien dakort me njëri-tjetrin për kujdestarinë e fëmijës dhe për vendbanimin e tij. Kjo marrëveshje mund të konfirmohet në zyrën komunale të socialit.

Në rast se nuk arrihet asnjë marrëveshje mbi kujdestarinë e fëmijës, atëhere konflikti mbi kujdestarinë zgjidhet në gjykatën komunale. Në vendimin e gjyqit influencojnë interesi i fëmijës dhe sqarimi i autoriteteve të punëve sociale mbi situatën midis prindërve.

Divorci i prindërve është një situatë e vështirë edhe për fëmijën dhe ai/ajo ka të drejtë që edhe pas divorcit të ketë kujdesin e të dy prindërve.

Kujdestaria e përbashkët kërkon nga të dy prindët, aftësi për bashkëpunim, edhe pse ata mund të kenë mosmarrëveshje me njëri-tjetrin. Nëse kushtet paraprake për kujdestari të përbashkët mungojnë, atëhere ajo mund të prishet dhe të emërohet njëri prej prindërve si kujdestar i vetëm, i fëmijës.

E drejta e takimit të fëmijës dhe alimentacioni

Fëmija ka të drejtë të ruajë marrëdhënie të afërta dhe të ngrohta si me nënën, ashtu edhe me babanë. Së bashku, prindët duhet të kujdesen që, fëmija të ketë mundësi të takohet mjaftueshëm me prindin, me të cilin ai/ajo nuk banon. Takimi me njërin nga prindët është e drejtë e fëmijës dhe ish-bashkëshorti (ish-bash-

këshortja) nuk mund t'ia ndalojë fëmijës një gjë të tillë.

Të dy prindët e fëmijës janë të detyruar për t'u kujdesur për alimentacionin e fëmijës. Nëse prindët nuk banojnë bashkë, atëhere fëmija ka të drejtë të marrë alimentacion nga prindin, me të cilin nuk banon.

Shuma e alimentacionit konfirmohet ose nëpërmjet kontratës me mbrojtësin e interesave të fëmijës ose nëpërmjet një vendimi gjykate. Në rast se prindi që është i detyruar për të paguar alimentacion, nuk mund të paguajë shumën e caktuar, atëhere fëmija ka të drejtë të marrë mbështetje financiare për alimentacion nga komuna e banimit. Informacione të mëtejshme mbi pozitën e fëmijës gjatë procesit të divorcit, japin autoritetet zyrtare të mbrojtjes së interesave të fëmijëve dhe zyrtarët e çështjeve sociale.

Ndarja e pasurisë gjatë divorcit

Në ndarjen e pasurisë gjatë divorcit ka rëndësi se, ligji i cilit shtet zbatohet.

Në rast se zbatohet ligji i Finlandës për divorc, atëhere zakonisht, e gjithë pasuria e bashkëshortëve ndahet në mënyrë të barabartë.

Bashkëshortët mund ta ndajnë pasurinë bashkarisht duke negociuar sipas një marrëveshjeje. Nëse për ndarjen e pasurisë nuk lind mirëkuptim, atëhere gjykata vendos një avokat për sqarimin e situatës.

Kontrata e martesës mundëson ndarjen e pasurisë jo në mënyrë të barabartë. Bashkëshortët mund të lidhin kontratë martesore para martesës ose gjatë saj.

Në kontratën martesore mund të përcaktohet se, pas divorcit, secili nga bashkëshortët mund të mbajë atë pjesë të pasurisë, sikundër është e përcaktuar në kontratë. Kontrata martesore ka pasojë për ndarjen e pasurisë edhe në rastin kur vdes njëri prej bashkëshortëve.

Kontrata duhet të hartohet me shkrim. Për hartimin e kontratës është mirë të kërkonti ndihmën e zyrës shtetërore, të ndihmës legale ose ndihmën e një avokati. Kontrata martesore duhet të regjistrohet në gjykatën komunale, të komunës së banimit.

➤ Shpesh forma të ndryshme të dhunës, shfaqen së bashku

- dhunë fizike, për shembull, është goditja, shtyrja, shqelmimi dhe mbytja (me duar).
- dhuna psikike është shantazhi, kërcënimi, akuzimi, nënçmimi, nënshtimi, frikësimi si dhe kufizimi i marrëdhënieve me miqtë dhe kushërinjtë.
- dhuna ekonomike është kur bashkëshortja nuk lejohet të shkojë në punë ose kur bashkëshortes nuk i jepen kurrfarë të hollash.
- dhuna seksuale është prekja në mënyrë seksuale pa dëshirën e tjetrit, ose detyrimi për të kryer marrëdhënie seksuale ose përdhunimi.

➤ Pasojat e divorcit në lejeqëndrim

1. Divorci (martesor dhe i bashkëjetesës) nuk ka kurrfarë pasoje për lejeqëndrimin e përhershëm.
2. Vazhdimi ose anulimi i lejeqëndrimit të përkohshëm, konsiderohet sipas rastit në fjalë.
3. Autoritetet zyrtare nuk e anulojnë lejeqëndrimin ose nuk japin vendim negativ për aplikimin për lejeqëndrim të ri, pavarësisht kërkesës së ish-bashkëshortit (ish-bashkëshortes).
4. Nëse marrëdhënia e çiftit ka përfunduar, për shkaqe të pavarura nga imigranti, si për shembull, në rastin e dhunës së ushtruar nga bashkëshorti, atëherë lejeqëndrimi mund të miratohet në bazë të reflektimit sipas rastit në fjalë. Edhe kallëzimi penal i bërë që më parë dhe dëshmitë e mjekut. Tregojnë për problemet në martesë dhe arsyet që kanë çuar në divorc.
5. Shtetasit të huaj, të cilit i është miratuar një lejeqëndrim i përkohshëm për arsye të lidhjes familjare, mund t'i miratohet një lejeqëndrim i ri edhe pas skadimit të arsyes familjare. duke u bazuar te fakti, se shtetasi i huaj ka krijuar lidhje të qëndrueshme me Finlandën. Nëse shtetasja e huaj është, për shembull, shtatzënë ose nëse ajo ka një fëmijë në Finlandë, një vend pune ose një të drejtë studimi, atëherë lejeqëndrimi miratohet pavarësisht divorcit.

Divorci kërkohet në gjykatën komunale

ALTERNATIVA 1

Bashkëshortët e plotësojnë bashkarisht ose njëri prej tyre e plotëson i vetëm formularin e divorcit dhe e dorëzojnë në gjykatën komunale.

Në këtë rast, bashkëshortët duhet të presin gjysëm viti, pra periudhën e reflektimit.

Divorci mund të miratohet, nëse pas gjashtë muajsh bashkëshortët e kërkojnë bashkarisht ose njëri prej bashkëshortëve e kërkon i vetëm divorcin, duke plotësuar një formulari të ri dhe duke e dorëzuar atë në gjykatën komunale.

ALTERNATIVA 2

Bashkëshortët kanë banuar larg njëri-tjetrit gjatë dy viteve të fundit.

Në këtë rast, bashkëshortët e plotësojnë bashkë ose njëri prej tyre e plotëson i vetëm formularin për divorc dhe e dorëzojnë atë në gjykatën komunale.

Divorci mund të miratohet menjëherë.

➤ Ndalimi kontaktit të mbron

Me ndalim të kontaktit ndaj një personi tjetër nënkuptohet që, për mbrojtjen e jetës, të shëndetit, të lirisë dhe të qetësisë së një personi, mund t'i ndalohet një personi tjetër që ta kontaktojë atë. Autoritetet zyrtare vendosin për ndalimin e kontakteve vetëm nëpërmjet formularit të personit që kërkon ndalimin e kontakteve. Dhuna nuk përbën parakusht për vendosjen e ndalimit të afrimit.

Ndalimi i kontaktit mund të kërkohet, për shembull, nëse kushëriri, ish-bashkëshorti (ish-bashkëshortja) ose personi me të cilin është bashkëjetuar, sillet në mënyrë kërcënuese. Ndalimi mund të kërkohet edhe për personat të cilët jetojnë në të njëjtën ekonomi familjare dhe në një rast të tillë, personi ndaj të cilit është vendosur ndalimi, duhet të largohet nga banesa e përbashkët.

➤ Shërbimet komunale të shëndetit mendor ndihmojnë personat me depresion

Simptomat e personit që vuan nga depresioni mund të jenë të ndryshme. Këto simptoma mund të jenë, për shembull, lodhja, pagjumësia, acarimi, paaftësia për t'i kuptuar gjërat e ndryshme dhe për të kryer punë të ndryshme. Simptomat mund të jenë edhe fizike, si për shembull, dhimbjet dhe therjet, të cilat nuk spjegohen nëpërmjet asnjë sëmundjeje fizike. Shërbimet komunale të shëndetit mendor ndihmojnë personat që vuajnë nga depresioni.

➤ Si mund të veproni menjëherë pas keqtrajtimit ose pas përdhunimit

- Mbani shënim emrat dhe kontaktet e dëshmitarëve të mundshëm
- Bëni kallëzim penal në polici
- Vizitohuni te mjeku dhe kërkoni një dëshmi për plagët e shkaktuara
- Pas përdhunimit mos u lani dhe as mos i ndërroni rrobat

Gjatë procesit të divorcit, bihet dakort për çështjet e fëmijëve

ALTERNATIVA 1

KUJDESTARIA E PËRBASHKËT

Me kujdestarinë e përbashkët, prindët mund ta rrisin bashkë fëmijën dhe të bien dakort bashkarisht mbi çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën edhe pas divorcit. Në praktikë për çështjet e fëmijëve vendos prindi me të cilin banon fëmija. Megjithatë, miratimi i kujdestarit tjetër nevojitet në vendime që kanë të bëjnë për shembull me:

- ndërrimin e vendbanimit të fëmijës (veçanërisht kur fëmija shpërngulet jashtë shtetit)
- miratimin e pasaportës së Finlandës
- masat që kanë të bëjnë me shëndetin e fëmijës
- ndryshimin e emrit ose të fesë
- shkollimin
- përdorimin e parave të fëmijës

ALTERNATIVA 2

KUJDESTARIA E VETME

Kujdestari i fëmijës, pra njëri prej prindërve kujdestar i vetëm për fëmijën dhe merr gjithashtu të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën.

Shkollimi dhe puna

Njohuritë e gjuhës finlandeze dhe suedeze si dhe diplomimi, përmirësojnë mundësitë për të gjetur punë. Shkollimi fillor është falas për të gjithë. Edhe shkollimi profesional dhe shkollimi i gjimnazit, që pason nivelin fillor të shkollimit, është kryesisht falas, por librat mësimorë duhet t'i blini vetë dhe ushqimi mund të jetë me pagesë. Gratë dhe burrat kanë të njëjtat mundësi shkollimi.

Shkollim për imigrantët

Në shumicën e komunave organizohet shkollim integruar për imigrantët. Gjatë shkollimit imigrantët mësojnë gjuhën finlandeze ose suedeze, njihen me shoqërinë finlandeze, marrin udhëzime lidhur me shkollimin dhe jetën e punës si dhe njihen me jetën e punës në Finlandë.

Krahas shkollimit të integrimin, shumë institucione shkollorë organizojnë kurse të gjuhës finlandeze dhe suedeze, posaçërisht për të huaj. Njohja e gjuhës dhe njohja me njerëz, për shembull, në aktivitete të kohës së lirë ose në organizata të ndryshme, lehtësojnë integrimin në shoqëri.

Si pikënisje për hartimin e shkollimit shërbejnë studimet e kryera dhe përvoja e punës jashtë shtetit. Informacione të mëtejshme mbi vazhdimin e studimeve në Finlandë dhe mbi njohjen e studimeve të kryera, mund të merrni në Administratën e Arsimit dhe në institucionet shkollorë.

Mundësi shkollimi për të rriturit

Burrat dhe gratë në moshë të rritur, të cilët shpërngulen nga jashtë shtetit në Finlandë, mund të kryejnë studimet e shkollimit fillor dhe të mesëm. Mësimi zhvillohet në gjimnazet për të rritur ose në shkollat popullore, krahas punës. Imigrantët mund të mësojnë një pro-

fesion ose të plotësojnë diplomën e mëparshme në qendrat e shkollimit profesional, për të rritur.

Personi mund të shkollohet në një profesion duke studiuar nëpërmjet kontratës mësimore. Gjatë studimit bëhet një ndërthurje e praktikës me teorinë. Për punën paguhet edhe një pagë.

Për të papunët që kërkojnë punë, organizohen shkollime për fuqinë punëtore, me kohëzgjatje të ndryshme, ku mund të aplikohet nëpërmjet zyrës së punësimit.

Në Finlandë, në të njëjtin vend pune, zakonisht punojnë si burra edhe gra. Gratë dhe burrat bëjnë të njëjtat detyra në vendin e punës. Ata kanë të njëjtat të drejta, detyrime dhe mundësi. Ligji i Finlandës e ndalon diskriminimin në vendin e punës për shembull, për shkak të gjinisë, ngjyrës së lëkurës ose të besimit fetar.

Zyra e punës dhe e punësimit ndihmon në gjetjen e punës

Zyra e punës dhe e punësimit ndihmon në gjetjen e punës. Ja vlen që të regjistroheshi në të, menjëherë pas mbërritjes tuaj në Finlandë. Kompensimi për papunësi nuk miratohet, nëse personi nuk është regjistruar në zyrën e punës dhe të punësimit, të komunës së banimit. Përveç vendeve të punës, atje ka infor-

macione edhe mbi mundësitë për praktikë pune dhe për shkollim. Gjetja e punës ka më shumë sukses, atëherë kur njeriu është aktiv dhe duke kontaktuar vetë me punëdhënësit.

Rëndësia e aktivitetit në kohën e lirë

Aktivitetet e kohës së lirë janë një mënyrë e lehtë për t'u njohur me finlandezët dhe për të mësuar gjuhën. Në Finlandë ka shumë mundësi për të qenë aktiv në kohën e lirë dhe për të marrë pjesë për shembull, në punë vullnetare ose në aktivitete të organizatave të ndryshme.

Një mënyrë për të ruajtur kulturën tuaj dhe për të takuar njerëz të rinj, është nëpërmjet pjesëmarrjes në organizatat e imigrantëve dhe vendeve shumëkulturore të argëtimit. Puna në organizata vullnetare dhe në organizata të ndryshme, mundëson mirëmbajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe aftësive tuaja. Informacione të mëtejshme mbi mundësitë për aktivitete në kohën e lirë që organizohen në komunën tuaj të banimit, mund të merrni, për shembull, në zyrat e komunës, për aktivitete kulturore dhe aktivitete të kohës së lirë, nga organizata dhe nga shoqata kulturore si dhe nëpërmjet njoftimeve në shtypin lokal.

Ndihmë në rast vështirësie financiare

Zakonisht në Finlandë, burrat dhe gratë e sigurojnë jetesën për vete dhe për familjet e tyre duke punuar. Shoqëria finlandeze siguron edhe të ardhurat për personat e papunë, për të moshuarit, për personat me aftësi të kufizuar

dhe për personat e sëmurë. Për këtë qëllim përdoren ndër të tjera, edhe paratë e grumbulluara nëpërmjet tatimit.

Sigurimi social në Finlandë, ka si kusht banimin në Finlandë. Duke përjashtuar disa raste, të gjithë personat që banojnë në Finlandë kanë të drejtë të sigurohen në KEELA, pra duke përfituar leverditë e miratuara nga Instituti i Sigurimit Social.

Ndihma elementare mujore është ndihma financiare e fundit. Personi ka të drejtë të marrë ndihmë elementare mujore në se, ai nuk arrin të sigurojë të ardhura të mjaftueshme jetese nëpërmjet punës ose nëpërmjet mënyrave të tjera. Shuma e ndihmës elementare mujore përcaktohet nëpërmjet të ardhurave dhe pasurisë. Kjo ndihmë miratohet nga zyra e socialit.

Diskriminimi dhe pushimi nga puna janë të ndaluara gjatë shtatzënisë ose gjatë lejes për familjen

Sipas ligjit të Finlandës, në momentin e marrjes në punë, nuk lejohet që punëtori të diskriminohet për shkak të shtatzënisë ose të lejes për familjen. Lejet për familjet janë leja e shtatzënisë, pushimi për babanë, pushimi për prindët dhe pushimi për t'u kujdesur për fëmijën (hoitovapaa). Gjithashtu, punëtori nuk mund të pushohet nga puna dhe kohëzgjatja e marrëdhënies së punës nuk mund të ndryshohet për shkak të këtyre arsyeve. Pas pushimeve për familjen, punëtori zakonisht ka të drejtë të kthehet në të njëjtin vend pune.



➤ Rrethi i mbrojtjes në punë mbikqyr kushtet e punës

Detyra e tetë rretheve të mbrojtjes në punë, të Finlandës është që të mbikqyrin dhe të krijojnë kushte të përshtatshme dhe sa më të sigurta pune dhe që përmirësojnë shëndetin dhe aftësinë në punë.

➤ Mbështetje financiare për studimin me kohë të plotë

Studentët që dëshirojnë të diplomohen në një profesion, mund të aplikojnë për mbështetje financiare për studimin dhe për qiranë dhe kjo ndihmon që studenti të përqendrohet në studimin me kohë të plotë. Për mbështetjen financiare për studim mund të aplikojnë shtetasit e huaj të cilët janë me banim të përhershëm në Finlandë, refugjatët dhe anëtarët e tyre të familjes si dhe personat që janë riatdhesuar në Finlandë. Informacione të mëtejshme mbi mbështetjen financiare për studim dhe për qira, mund të merrni në zyrat e Institutit të Sigurimit Social, (KELA). Studenti mund të aplikojë edhe për një hua për studentë.

➤ Kontrata e punës me shkrim dhe anëtarësimi në sindikatë profesionale

Para fillimit të marrëdhënies së punës, punëdhënësi dhe punëtori hartojnë një kontratë pune me shkrim. Në kontratë përcaktohet, ndër të tjera, paga dhe orari i punës. Punëtori është i lirë të anëtarësohet në sindikatën profesionale të profesionit përkatës dhe sindikata i këshillon anëtarët e saj për çështjet që lidhen me pagat, orarin e punës dhe kushtet e tjera të punës. Për të gjetur sindikatën e duhur profesionale, pyesni kolegët e punës. Në Finlandë, anëtarësimi në sindikata është i zakonshëm.

Të ardhurat nga rroga që përfitojnë gratë ose burrat, përbëjnë pasurinë e tyre personale. Zakonisht, punëdhënësi e bën pagesën e rrogës, në llogarinë bankare të punëtorit. Llogarinë bankare mund ta hapni në një bankë që dëshironi dhe për hapjen e saj është e nevojshme një pasaportë e vlefshme ose një letërnjoftim.

➤ Tatimet duhen paguar nga paga

Çdo njeri që punon në Finlandë i paguan tatimet nga paga personale si shtetit ashtu edhe komunës së banimit. Personat me të ardhura më të larta paguajnë më shumë tatime, se sa ata që kanë më pak të ardhura. Punëdhënësi kujdeset për pagesën e tatimeve, në bazë të kartës tatimore të punëtorit. Punëtori duhet t'i dorëzojë punëdhënësit kartën tatimore, menjëherë pas fillimit të marrëdhënies së punës. Kartën tatimore mund ta merrni në zyrën e tatimeve, të komunës së banimit.

➤ Në kontratën e punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë kushtet mbi përfitimet minimale

Në bazë të ligjit të Finlandës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë udhëzimet mbi përfitimet minimale, që kanë të bëjnë me pagën, me pushimet e paguara, në bazë të ditëve të punës dhe me orarin e punës.

➤ **Plani i integritimit ndihmon në gjetjen e punës dhe garanton të ardhurat e jetesës**

Nëse personi që është shpërngulur në Finlandë, nuk gjen punë ose vend shkollimi ose nëse ai/ajo detyrohet të mbështetet te ndihma elementare mujore, atëherë personit mund t'i hartohet një plan integritimi, në zyrën e punës dhe e sipërmarrjes ose në zyrën e socialit. Qëllimi i këtij plani është të ndihmojë punësimin e imigrantëve dhe integrimin e tyre në shoqërinë finlandeze. Shpesh, plani përmban edhe mësim të gjuhës finlandeze, shkollim profesional plotësues dhe praktikë pune. Ndërsa imigranti zbaton planin e integritimit, të ardhurat e jetesës i garantohen nëpërmjet ndihmës financiare të integritimit.

➤ **Për punë nevojitet leja e punës**

Imigrantët, me përjashtim të disa rasteve të rralla, kanë nevojë për leje pune që të punojnë në Finlandë. Leja e punës miratohet nga Drejtoria e Migracionit.

➤ **Punësimi përmirëson pensionin**

Të ardhurat nga puna influencojnë në pavarësinë ekonomike edhe pasi që personi del në pension. Zakonisht, në Finlandë, moshë e pensionit është 65 vjeç. Shuma e pagës mujore influencën edhe në pagesën mujore të pensionit.

➤ **Duhet të tregoni kujdes në nënshkrimin e kontratave të ndryshme**

Para se të nënshkruani kontrata të ndryshme, duhet të kuptoni brendinë e tyre. Sidomos në rastin e kontratave të punës dhe për kontrata të tjera. Kontratat me shkrim janë detyruese. Nëse nuk keni aftësi të mjaftueshme gjuhësore për të kuptuar, atëherë rekomandohet përkthyesi. Kushtet e kontratave të cilat konsiderohen si të padrejta, mund të prishen me vendim gjykatë, në bazë të ligjit të Finlandës.

➤ **Ndihmë në çështjet juridike**

Në Finlandë, ndihmë për të gjitha çështjet juridike ofrojnë zyrat shtetërore të ndihmës legale, avokatët dhe juristët e tjerë. Personat me të ardhura të pakta, kanë mundësi ta marrin falas ndihmën juridike, në zyrat shtetërore të ndihmës legale.

Trafikimi i qenieve njerëzore

Në Finlandë, trafikimi i qenieve njerëzore është një krim që dënohet rreptësisht.

Viktima nga trafikimi i qenieve njerëzore mund të jenë gra, burra ose fëmijë. Nëpërmjet trafikimit të qenieve njerëzore, synohet shfrytëzimi seksual ose/dhe ekonomik i viktimës. Shpesh, në origjinën e këtij fenomeni gjendet një borxh, i cili më vonë, kërkohet që viktima ta shlyejë nëpërmjet punës ose prostitucionit.

Keqbërësit kërkojnë ta kontrollojnë viktimën për shembull, nëpërmjet kufizimit të lirisë së lëvizjes, kërcënimit, presionit ose duke përdorur dhunë psikologjike dhe/ose fizike. Kërcënimi mund të përfshijë edhe të afërmit e viktimës. Shpesh, trafikimi i qenieve njerëzo-

re është një aktivitet që drejtohet nga grupe të organizuara kriminale. Megjithatë, në trafikimin e qenieve njerëzore mund të përfshihen edhe të afërmit ose të njohurit e viktimës.

Viktima nga trafikimi i qenieve njerëzore ka të drejtë për të marrë ndihmat që ofrohen për viktimat nga trafikimi i qenieve njerëzore: për banim, për ndihmën elementare mujore, për shërbimet sociale dhe shëndetësore, për këshilltar të çështjeve legale dhe për ndihmë legale, për sigurinë si dhe për lejeqëndrim, në bazë të kushtit që personi banon në mënyrë të paligjshme në Finlandë.

► Ndhimë për viktimat nga trafikimi i qenieve njerëzore

Qendra e pranimit të refugjatëve, e Joutseno-s tel.071 876 3170

Bashkimi i grave "Monika" tel. (09) 692 2304

Urgjenca për viktima të krimit, www.riku.fi

Policia, Numri i urgjencës tel.112

Autoritete të rëndësishme zyrtare

Në punët me autoritetet zyrtare, duhet që fillimisht të kontaktoni autoritetet zyrtare, lokale, të vendbanimit tuaj. Vetëm në rast se çështja nuk është zgjidhur, mund të kontaktoni autoritetet zyrtare, të nivelit komunal.

DREJTORIA E MIGRACIONIT

www.migri.fi
Lautatarhankatu 10
00580 Helsinki
Informacione të përgjithshme
Tel. 071 873 3400
E hënë – e premte ora 9-15

IN TO

www.intofinland.fi
posta elektronike: info@intofinland
Salomonkatu 17, A-porras, 2. krs
PL 82, 00601 Helsinki
In To një shërbim i Kela-s dhe
Administratës Tatimore për punëtorët
që do të shpërngulen në Finlandë.

KELA, INSTITUTI I SIGURIMIT SOCIAL

www.kela.fi
Instituti i Sigurimit Social, Kela,
kujdeset për sigurimin social të
banorëve të Finlandës në situata
të ndryshme të jetës.

ZYRA E OMBUDSMANIT PËR BARAZINË

www.tasa-arvo.fi
Tel. (09) 160 73248
Ombudsmeni për barazinë mbikqyr
zbatimin e ligjit të barazisë, midis
grave dhe burrave.

ZYRA E PUNËS DHE E SIPËRMARRJES

www.mol.fi

ZYRA SHETËTËRORE E NDIHMËS LEGALE

www.oikeus.fi

UDHËZIME PËR NDIHMËN LEGALE

Tel. 0100 86200 ndihmon për më tej Shteti
ka zyra të ndihmës legale, të cilat japin
ndihmë për çështjet juridike. Emërtimi zyrtar
i juristëve të cilët punojnë në zyrat shtetëro-
re, të ndihmës legale, është ndihmësi publik
legal.

ZYRA E OMBUDSMANIT PËR MINORITETET

www.ofm.fi
Posta elektronike: ofm@ofm.fi
Tel. 071 878 0171
Qëllimi i zyrës së ombudsmanit për minorite-
tet është të parandalojë diskriminimin,
të përkrahë marrëdhëniet e mira ndër-etnike,
të sigurojë të drejtat e minoriteteve dhe të të
huajve, si dhe të mbikqyrë zbatimin e parimit
të mosdiskriminimit etnik.

Burime informacioni

WWW.INFOPANKKI.FI

Në faqet e internetit, të Infopankki-t ka infor-
macione bazë, të rëndësishme për imigrantët
mbi funksionimin e shoqërisë dhe mbi mun-
dësitë që ka Finlanda. Informacionet jepen në
shumë nga gjuhët e imigrantëve.

Organizata dhe shërbime ndihmëse

TELEFONI I PËRGJITHSHËM PËR VIKTIMAT NGA TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

Tel. 071 876 3170

Qendra për pranimin e refugjatëve,
e Joutseno-s

QENDRA E REHABILITIMIT PËR PERSONAT E TORTURUAR

Instituti i Dhjakonisë, së Helsinkit

www.hdl.fi

Mäkelänkatu 58-60, kati 4-t., 00510 Helsinki

Tel. (09) 7750 4584

gjatë javës ora 8.30-15.00

QENDRA E OULU-T E SHËRBIMEVE PËR REHABILITIMIN E PERSONAVE TË TORTURUAR

Instituti i Dhjakonisë së Oulu-t

www.odl.fi

Isokatu 19 A 8, 90100 Oulu

Tel. (08) 3132692

Klientët janë refugjatët, azilkërkuesit dhe të afërmit e tyre, të cilët kanë qenë viktime të torturave në atdheun e tyre. Trajtimi bazohet në vlerësimin e përgjithshëm të situatës së klientit dhe realizohet si nëpërmjet konsultimit dhe me profesionalitet.

BASHKIMI I GRAVE "MONIKA" RY

Ofron dhe zhvillon shërbime për gra, vajza dhe fëmijë imigrantë, që kanë qenë objekt i dhunës në çift dhe në familje.

www.monikanaiset.fi/

Monika-Naiset liitto ry

Kinaporinkatu 2 E 40, 00500 Helsinki

Telefon (09) 7279 9999

Posta elektronike: info@monikanaiset.fi

Telefoni i përgjithshëm i urgjencës:

(09) 692 2304

PRO-TUKIPISTE

www.pro-tukipiste.fi

Vilhonkatu 4 B 20, Helsinki

Posta elektronike: toimisto@pro-tukipiste.fi

Tel. (09) 726 2877

PRO-TUKIPISTE TAMPERE

Aleksis Kiven katu 10 E, Tampere

Tel. (03) 3454 2200

Shoqata ofron shërbime nëpërmjet të cilave ndihmon në shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e njerëzve, të cilët punojnë në fushën e seksit.

URGJENCA PËR VIKTIMAT NGA PËRDHUNIMI "TUKINAINEN"

www.tukinainen.fi

Tel. 0800-97895

URGJENCA PËR VIKTIMA TË KRIMIT

Linja telefonike për ndihmë

www.riku.fi/fi/etusivu/

Tel. 0203 16116

Detyra bazë e urgjencës për viktimat e krimit është të përmirësojë pozitën e viktimës së krimit, të të afërmit të saj/tij dhe pozitën e dëshmitarit në një çështje penale. Shërbimet realizohen kryesisht si punë vullnetare e organizuar në mënyrë profesionale.

QENDRA SOS E KRIZËS

www.tukinet.net

Qendra SOS – qendra për të thuar,
për parandalimin e krizave

(SOS Center – Crisis prevention for foreigners)

Tel. (09) 4135 0501, gjatë javës ora 9-15

Qendra SOS (SOS-keskus)

Maistraatinportti 4 A, kati i 4-t, 00240 Helsinki

Qendra SOS, e Shoqatës për Shëndetin

Mendor në Finlandë ofron ndihmë dhe

mbështetje psikologjike në raste krize.

Në rast se dëshiron, personi mund ta marrë

ndihmën edhe si person anonim.

LOUNAIS-SUOMEN MIELENTERVEYSSEURA RY

Shërbimet në raste krize për imigrantë

www.turunkriisikeskus.fi

Yliopistokatu 12 a B, 20100 Turku

Tel. (02) 233 3442

Shërbimet për kriza ndihmojnë klientët për probleme akute me shëndetin mendor dhe me jetën sociale. Ndihma në rast krize që duhet dhënë në mënyrë profesionale, ripërtërin, jep mbështetje dhe spjegime.



SISÄASIAINMINISTERIÖ

MINISTRIA E BRENDSHME
PL 26, 00023 VALTIONEUVOSTO
www.intermin.fi



VÄHEMMISTÖVALTUUTETTU

OMBUDSMANI PËR MINORITETE
PL 26, 00023 VALTIONEUVOSTO
www.ofm.fi



TASA-ARVOVALTUUTETUN TOIMISTO

ZYRA E OMBUDSMANIT PËR BARAZINË
PL 33, 00023 VALTIONEUVOSTO
www.tasa-arvo.fi